



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.06, datë 09.11.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**

**“PËRMIRËSIMI I SIGURISË SË KOMPLEKSIT TË AMBASADËS TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, PRISHJE E PJESSHME E MURIT RRETHUES, PRISHJE E ÇATISË SË OBJEKTIT EKZISTUES 1 KAT DHE SHITESË ANËSORE OBJEKT 1 KAT, ME ÇATI TË PËRBASHKËT TË PASHFRYTËZUESHME”**


Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Përmirësimi i sigurisë së kompleksit të Ambasadës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, prishje e pjesshme e murit rrethues, prishje e çatisë së objektit ekzistues 1 kat dhe shtesë anësore objekt 1 kat, me çati të përbashkët të pashfrytëzueshme”, me subjekt zhvillues Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOFA

